



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr . 300/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Ymer Hoxha dhe Adnan Konushevcu anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur lidhur me ankesën e BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, me seli në Prishtinë, paraqitur ndaj Koalicioni PDK-AAK-NISMA, për shkak të vendosjes së posterave në afërsi të Qendrave të Votimit (QV) gjatë ditës së votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 13.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa Anr 300/2017 e datës 12.06.2017 e parashtruar nga BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA

A r s y e t i m

Parashtruesi i ankesës, BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, me seli në Prishtinë, me datën 12.06.2017, ka parashtruar ankesë në PZAP, me të cilën pretendohet se Koalicioni PDK-AAK-NISMA pranë Qendrës së Votimit 0401X në Gjilan afër oborrit të shkollës “Thimi Mitko” ka qenë i vendosur poster i kandidatit Rexhep Kadriu nga subjekti politik AAK. Parashtruesi i ankesës pretendon se kjo është në kundërshtim me nenin 36 LZP.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe provave materiale-fotografisë së bashkangjitur, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Parashtruesi i ankesës me ankesën e tij pretendon se pranë Qendrës së Votimit 0401X në Gjilan afër oborrit të shkollës “Thimi Mitko” ka qenë i vendosur poster i kandidatit Rexhep Kadriu nga subjekti politik AAK

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë nuk ka ofruar dëshmitë të qarta dhe bindëse për të vërtetuar pretendimet ankimore edhe pse barra e te

provuarit bie mbi parashtruesin e ankesës, në kuptim të nenit 117 par.3 të LZP-së, për të provuar se shkelësi i supozuar. Nga fotografia e ofruar si provë nuk mund të identifikohet se sa metra është larg qendra e votimit dhe njëkohësisht objekti që pretendohet nga parashtruesi i ankesës së është QV nuk e ka provuar me prova për të vërtetuar pretendimet e tij

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr 300/2017 më datën 13.06.2017



Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur, mund të paraqet ankesë brenda afatit prej njëzet e katër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi në Gjykatën Supreme.*